

Specialist (Profili teknik)/Sektori i Analizës së Përputhshmërisë dhe Kontrollit, Drejtoria e Analizës së Përputhshmërisë, Riskut dhe Kontrollit të Masave të Sigurisë Kibernetike, në Autoritetin Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike.

Në zbatim të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, ligjit nr. 9880, datë 25.02.2008, "Për nënshkrimin elektronik" i ndryshuar, ligjit nr. 107/2015 "Për identifikimin elektronik dhe shërbimet e besuara", i ndryshuar, ligjit nr.2/2017 "Për Sigurinë Kibernetike", vendimit të Këshillit të Ministrave nr.141, datë 22.02.2017 "Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike", i ndryshuar, vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 325, datë 31.05.2023 "Për miratimin e strukturës së pagave, niveleve të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë të zëvendësministrit, funksionarëve të kabineteve, prefektit, nënprefektit, nëpunësve civilë dhe punonjësve në disa institucione të administratës publike", vendimit të Këshillit të Ministrave nr.763, datë 12.12.2022 "Për caktimin e masës së shtesës për natyrë të veçantë pune për drejtorin e përgjithshëm dhe nëpunësit në njësitë teknike të përmbajtjes së AKCESK", i ndryshuar, urdhrin të Kryeministrit nr. 233, datë 20.12.2023 "Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Autoritetit Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike", Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike shpall konkurrimin për 1 (një) vend të lirë pune në pozicionin:

- **Specialist (Profili teknik)/Sektori i Analizës së Përputhshmërisë dhe Kontrollit, Drejtoria e Analizës së Përputhshmërisë, Riskut dhe Kontrollit të Masave të Sigurisë Kibernetike, në Autoritetin Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike.**

DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË E POZICIONIT PËRMBAJNË POR NUK KUFIZOHEN NË:

- Kontrollon dokumentimin dhe implementimin e masave minimale të sigurisë, teknike dhe organizative, nga operatorët e Infrastrukturave Kritike dhe të Rëndësishme të Informacionit, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe standardet ndërkombëtare;
- Kontribuon në përgatitjen, hartimin e rekomandimeve për mirëqeverisjen e sigurisë kibernetike të Infrastrukturave Kritike dhe të Rëndësishme të Informacionit;
- Kontrollon Ofruesit e Kualifikuar të Shërbimeve të Besuara për ushtrimin e veprimtarisë së tyre, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi;
- Përgatit kalendarin e auditit, duke koordinuar punën me specialistët ligjorë dhe përgjegjës të sektorit për kontrollin periodik të OIKI, OIRI dhe OKSHB;
- Mban korrespondencën me Operatorët e Infrastrukturave Kritike dhe të Rëndësishme të Informacionit dhe Ofruesit e Kualifikuar të Shërbimit të Besuar, me qëllim mbarëvajtjen e procesit të kontrollit;
- Përgatit draft-raportin e kontrollit të kryer pranë OIKI, OIRI dhe OKSHB;
- Siguron ndihmë metodike, kur i kërkohet, strukturave të tjera të Autoritetit;
- Me miratimin e eprorit kryen detyra të veçanta në ndihmë të sektorëve të tjerë, si dhe merr pjesë në grupe të ndryshme pune, komisione, konferenca kombëtare e ndërkombëtare duke përfaqësuar Autoritetin.

KËRKESA TË PËRGJITHSHME PËR KANDIDATËT

Arsimi: Niveli minimal i diplomës "Master Profesional", në Teknologji Informacioni/ Inxhinieri Kompjuterike/ Inxhinieri Informatike/ Inxhinieri Telekomunikacioni/ Inxhinieri Elektronike/ Shkenca Kompjuterike/ Inxhinieri Elektrike/ Informatikë Ekonomike.

Përvoja: Të ketë të paktën 3 vite përvojë pune në profesion. Përbën avantazh eksperiencë e punës në fushën e kontrollit të sigurisë kibernetike/teknologjisë së informacionit dhe infrastrukturave të çelësive publik (PKI).

FUSHA E NJOHURIVE:

Kandidatët do të intervistohen mbi fushën e njohurive si më poshtë:

- Legjislacionin e sigurisë kibernetike;
- Legjislacionin mbi identifikimin elektronik dhe shërbimet e besuara;
- Specialitetet brenda fushës së caktuar profesionale;
- ISO 27001:2013

Aftësi për të:

- Integruar informacionin me politikat institucionale;
- Identifikuar dhe qartësuar çështje e dhënë mendime alternative të mbështetura në përvojën profesionale;
- Analizuar, komunikuar, prezantuar, si dhe për të pranuar metoda dhe procedura të reja;
- Përparësi certifikime profesionale të fushës si: ISO 27001:2013 ‘Lead Auditor’; CISA, CISSP; ‘Cyber Intelligence’, ‘Information System Auditing’; ‘Conformity Assessment Body–eIDAS Regulation (EU) 910/2014’; ‘International Laë of Cyber Operation’; CompTIA Security+;
- Të njohë mirë gjuhën angleze.

Çdo kandidat jo-kualifikues pas procesit të intervistës, ka të drejtë për ankim jo më vonë se 2 (dy) ditë kalendarike pas marrjes së njoftimit.

PAGA PËR POZICIONIN ËSHTË NË KLASËN (IV-1)

PARAQITJA E DOKUMENTEVE:

Kandidati duhet të dërgojë brenda datës 10.01.2024, në Autoritetin Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike, në adresën: Rruga “Papa Gjon Pali II”, Nr. 3, Kati I, Tiranë ose në adresën e e-mailit: burimet.njerezore@cesk.gov.al, këto dokumente:

- Kërkesë për aplikim;
- CV (sipas formatit europass në gjuhën shqipe);
- Fotokopje të diplomave që disponon dhe listës së notave;
- Diplomat e përfunduara jashtë vendit duhet të shoqërohen edhe me dokumentin e njohjes nga institucionet përkatëse, sipas legjislacionit të arsimit të lartë;
- Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- Fotokopje të certifikatave të kualifikimit (nëse ka);
- Fotokopje të dëshmimeve të gjuhëve të huaja;
- Vërtetimin e gjendjes gjyqësore;
- Të paktën një letër rekomandimi.

Mosparaqitja e plotë dhe brenda afatit e dokumenteve sjell shkualifikim të kandidatit.